


BLLOQET E MBLOCK

Më tutje mund të ndiqni disa prej blloqeve të aplikacionit „mBlock”.

1. Përdorimi i dritave LED (E kuqe, e gjelbër dhe e kaltër)

Ky bllok shërben për ndezjen e dritave LED të cilat kanë tri ngjyra bazë (të kuqe, të gjelbër dhe të kaltër).



all
led left
led right

Me klikimin e kësaj shigjete, na mundësohet që të zgjidhim se cilën nga dritat LED duam të ndezim, të majtën, të djathtën apo të dyja.

0
20
60
150
255


Me klikimin e këtyre shigjetave, na mundësohet të zgjidhim intensitetin e dritës me ngjyrën përkatëse.

2. Sensori i distancës

Ky bllok shërben për vënien në funksion të sensorit të distancës.



ultrasonic sensor Port3 distance



Varësisht portit ku është lidhur përmes kabllor edhe sensorin në mBot, e zgjedhim njërin nga portet e mundshme.

3. Përdorimi i butonit

Butoni i mBot i ka 2 veprime të paracaktuara:

1. Shmangja e pengesave, dhe
2. Ndjekja e vijës

Kur të shtypet butoni një herë, do të ndezet drita e gjelbër dhe do të aktivizohet veprimi i parë, kurse nëse shtypet butoni dy herë, ndizet drita e kaltër dhe aktivizohet veprimi i dytë.